



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 3652 prot.

Tiranë, më 08.7.2020

UDHËZIM

Nr. 20, datë 08.7.2020

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 13, DATË 22.5.2019,
“PËR PROCEDURAT E PRANIMIT E TË EMËRIMIT TË MËSUESIT NË NJË
VEND TË LIRË PUNE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR DHE PËR ADMINISTRIMIN E PORTALIT “MËSUES
PËR SHQIPËRINË”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 1 të nenit 60 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

- I. Në udhëzimin nr.13, datë 22.5.2019, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:
 1. Në pikën 7 të kreut 1, togfjalëshi “...deri në 1 (një) ditë, para fillimit të vitit mësimor.”, zëvendësohet me togfjalëshin “...jo më vonë se 1 (një) muaj para fillimit të vitit mësimor.”.
 2. Në pikën 6 të kreut 7, togfjalëshi “...brenda muajit gusht.”, zëvendësohet me togfjalëshin “...brenda muajit korrik.”.
 3. Në kreun 10 pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:
“3/1. Mësuesit e pranuar sipas procedurave të Portalit “Mësues për Shqipërinë” apo procedurave ligjore para fillimit të zbatimit të Portalit “Mësues për Shqipërinë”, të emëruar me konkurrim apo komanduar si drejtorë apo nëndrejtorë të institucioneve arsimore publike, pas përfundimit të ligjshëm të ushtrimit të këtij funksioni, rikthehen në pozicionin e mësuesit, sipas procedurave të këtij udhëzimi dhe shtojcës 2.1.”.
- II. Shtojcat 2.1 e udhëzimit zëvendësohen me shtojcën me të njëjtin numër bashkëlidhur këtij udhëzimi.

III. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore .

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Besa SHAHINI



SHTOJCA 2.1 Kriteret dhe skema e vlerësimit të dosjeve të kandidatëve që ngelen pa ngarkesë mësimore dhe kandidatëve që aplikojnë për lëvizje paralele.

1	<p>Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II)/2, ose nota mesatare DIND. Konvertimi i notës mesatare në pikë bëhet si më poshtë:</p> <p>5.00 - 5.50 = 0.5 pikë 5.51 - 6.00 = 1 pikë 6.01 - 6.50 = 1.5 pikë 6.51 - 7.00 = 2 pikë 7.01 - 7.50 = 2.5 pikë 7.51 - 8.00 = 3 pikë 8.01 - 8.50 = 3.5 pikë 8.51 - 9.00 = 4 pikë 9.01 - 9.50 = 4.5 pikë 9.51 - 10.00 = 5 pikë</p>	0.5-5 pikë
2	<p>Shkallët e kualifikimit:</p> <p>a) Në rast se kandidati zotëron provimin e licencës 1 pikë b) Mësues i kualifikuar (kategoria III) 2-4 pikë. (2 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”; 3 pikë për vlerësimin “Mirë”; 4 pikë për vlerësimet “Shumë mirë” ose “Shkëlqyeshëm”) c) Mësues specialist (kategoria II) 5-7 pikë (5 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”; 6 pikë për vlerësimin “Mirë”; 7 pikë për vlerësimet “Shumë mirë” ose “Shkëlqyeshëm”) d) Mësues mjeshtrë (kategoria I) 8-10 pikë (8 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”; 9 pikë për vlerësimin “Mirë”; 10 pikë për vlerësimet “Shumë mirë” ose “Shkëlqyeshëm”)</p>	1-10 pikë
3	<p>Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja: Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 2 pikë. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1 = 2 pikë. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 4 pikë. Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti kur gjuha e huaj është e mbrojtur në kuadër të përfundimit të studimeve universitare të ciklit të dytë, sipas legjislacionit përkatës. Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë se 4 pikë në vlerësimin e dosjes. Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për një dëshmi. Kandidatit të profilit gjuhë e huaj, i njihen pikët e kësaj rubrike, përveç gjuhës së huaj për të cilën është diplomuar. Dokumenti i njohjes së gjuhës së huaj duhet të jetë lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për ofrimin e testeve ndërkombëtare. Lista e subjekteve të njohura nga MASR, që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale mbi testimet ndërkombëtare, është sipas Udhëzimit nr. 52, datë 03.12.2015, i ndryshuar. Lista shpallet në faqen zyrtare të MASR.</p>	0-4 pikë
4	<p>Certifikata trajnimesh: Certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë ose nga agjenci trajnuese që janë akredituar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: a) deri në 3 kredite = 1 pikë; b) mbi 3 kredite = 2 pikë.</p>	0-2 pikë

5	<p>Vlerësimi i përfaqësuesve të prindërve. Përfaqësuesit e prindërve të nxënësve, ku mësuesi jep mësim, vlerësojnë me pyetësor punën e këtij mësuesi me nivelet: “Sh. Mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët”.</p> <p>Vlerësimi “Sh. mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë Vlerësimi “Mjaftueshëm” = 1 pikë Vlerësimi “Dobët” = 0 pikë</p>	0-2 pikë
6.	Vlerësimi i psikologut dhe i punonjësit social të institucionit arsimor	0-2 pikë
7.	<p>Vlerësimi i drejtorit të institucionit arsimor, bazuar në vlerësimin e performancës, e shprehur në nivelet: “Sh. Mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët”.</p> <p>Vlerësimi: “Sh. mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë Vlerësimi: “Mjaftueshëm” = 1 pikë Vlerësimi: “Dobët” = 0 pikë</p>	0-2 pikë